

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24 dhe 193/24), dhe në lidhje me nenin 141 paragrafi 13 nga Ligji i njëjtë, pika 8 dhe pika 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (Tekst i pastruar) ark.nr.01-4139/1 datë 07.11.2022, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.11-2615/1 datë 19.06.2025 dhe Konkluzionin ark.nr.02-2840/7 datë 07.07.2025, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 2-të mbajtur më 07.07.2025, miratoi si vijon:

Aktvendim për paralajmërim publik dhe për shkyçje nga ritransmetimi të shërbimeve programore

1. **PUBLIKISHT PARALAJMËROHET** Operatori i rrjetit publik të komunikimit elektronik, Shoqëria tregtare për prodhim, tregti dhe shërbime ALTRA - SAT 2000 SHPKNJP Ohër, për shkak të ritransmetimit të shërbimeve programore që nuk janë të regjistruar në Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia) në përputhje me nenin 141 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV).

Shkelja nga paragrafi (1) të kësaj pike është specifikura në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.11-2615/1 datë 19.06.2025, që është pjesë përbërëse e këtij aktvendimi si Shtojcë nr.1.

2. **URDHËROHET** që Operatori i rrjetit publik të komunikimit elektronik, Shoqëria tregtare për prodhim, tregti dhe shërbime ALTRA - SAT 2000 SHPKNJP Ohër, menjëherë pas pranimit të këtij aktvendimi të harmonizojë veprimtarinë e tij me dispozitat e LSHMAAV, përkatësisht të shkyçë ritransmetimin e shërbimeve programore.

3. Të kryhet mbikëqyrje kontrolli, me qëllim të përcaktimit nëse subjekti i mbikëqyrjes i cekur në pikën 1 të këtij aktvendimi, ka vepruar sipas aktvendimit për vërejtje publike dhe për shkyçje nga ritransmetimi të shërbimeve programore.

4. Nëse subjekti i mbikëqyrjes i cekur në pikën 1 të këtij aktvendimi, nuk vepron sipas aktvendimit, përkatësisht vazhdon të kryejë shkelje për të cilën është paralajmëruar publikisht, Agjencia, në përputhje me nenin 23 paragrafi (1) nënparagrafi 2 të LSHMAAV, do të paraqesë kërkesë për inicim të procedurës kundërvajtëse para gjykatës kompetente.

5. Ky Aktvendim është përfundimtar, dhe dita e miratimit të tij llogaritet dita e çertifikimit në Arkivin e Agjencisë.

A r s y e t i m

Agjencia në përputhje me nenin 6 paragrafi (1) nënparagrafi 4 të LSHMAAV, ndërmerr masa në përputhje me këtë ligj në rastet kur është kryer shkelje e dispozitave të LSHMAAV ose të dispozitave të miratuara në bazë të ligjit dhe kushteve dhe detyrimeve nga lejet.

Në bazë të nenit 28 të LSHMAAV, Agjencia është kompetente të kryejë mbikëqyrje programore (monitorim) të programeve të transmetuesve dhe ofruesve të shërbimeve mediatike me kërkesë, si dhe të pakove programore që ritransmetohen nga operatorët e rrjetit publik të komunikimit elektronik nga aspekti i respektimit të dispozitave të ligjit, lejet, çertifikatat e dhëna për regjistrim, aktet nënligjore dhe akte të tjera të miratuara nga Agjencia.

Në kuadër të kompetencave ligjore, dhe në përputhje me nenin 27 dhe nenin 28 të LSHMAAV, Agjencia më 18.06.2025, ka kryer mbikëqyrje të rregullt programore të pakos programore të ritransmetuar nga operatori Shoqëria tregtare për prodhim, tregti dhe shërbim ALTRA - SAT 2000 SHPKNJP Ohër, ku është konstatuar se operatori në fjalë që sipas notifikacionit të Agjencisë për Komunikime Elektronike mund të kryejë veprimtari në teritorrin e komunës Ohër, më 18.06.2025, për shfrytëzuesit e tij ka ritransmetuar shërbime programore, që nuk mbulohen me çertifikatë për regjistrim

të shërbimeve programore të dhënë nga Agjencia, që është në kundërshtim me nenin 141 paragrafi 13 të LSHMAAV. Konstatimet nga mbikëqyrja janë detajisht të specifikuara në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore, ark.nr.11-2615/1 datë 19.06.2025, që është pjesë përbërëse e këtij aktvendimi si Shtojcë nr.1.

Rrjedhimisht nga sa më sipër, në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të LSHMAAV, dhe në lidhje me nenin 141 paragrafi 13 nga Ligji i njëjtë, pika 8 dhe pika 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.11-2615/1 datë 19.06.2025 dhe Konkluzionin ark.nr.02-2840/7 datë 07.07.2025, për konstatim të mos respektimit të dispozitave të LSHMAAV, cekur në pikën 1. të këtij aktvendimi, Këshilli i Agjencisë, miratoi aktvendim me të cilën ndaj subjektit të lartpërmendur të ndërmerret masë vërejtje publike dhe urdhërohet menjëherë pas pranimit të aktvendimit të harmonizojë veprimtarinë e tij me dispozitat e LSHMAAV, të mënyrës që do të shkyçë ritransmetimin e shërbimeve programore.

Agjencia, do të kryejë mbikëqyrje kontrolli, me qëllim të përcaktimit nëse subjekti në fjalë ka vepruar sipas urdhëresës, përkatësisht sipas vërejtjes publike dhe ka ndërprerë me ritransmetim të shërbimeve programore.

Në përputhje me nenin 24 të LSHMAAV, ky aktvendim është përfundimtar dhe kundër tij operatori i rrjetit publik të komunikimit elektronik ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritje të kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

Bazuar nga sa më sipër, u miratua aktvendimi si në dispozitiv.

Shtojcë (1):

- Raport me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore, ark.nr.11-2615/1 datë 19.06.2025.

Përktheu: Antoneta Shabani

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kraetar i Këshillit**

Mr. Sasho STEFANOVSKI

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi operatori i rrjetit publik të komunikimit elektronik ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritje të kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.